

STATUTI I SHOQËRISË
Idealdevs Corporation sh.p.k

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Ortakët

1.1 Ortakët e Shoqërisë janë si vijon më poshtë:

1.1.1 Orgito Baraj, qytetar me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 09/11/2003, shtetas shqiptar, mbajtës i Pasaportës/Letërnjoftimit me Nr. Personal K31109018T, zotëron 1 kuotë, që korrespondon me 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Neni 2
Emri

2.1 Emri i shoqërisë është: Idealdevs Corporation sh.p.k (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Neni 3
Selia e Shoqërisë

3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Lagja "BARAJ 01960008" Nd. 64, H. 1.

3.1 Shoqëria mund të hapë degë, njësi, agjenci, dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë Shqipërisë në përputhje me dispozitat e aplikueshme ligjore në fuqi dhe procedurat e regjistrimit.

Neni 4
Forma Ligjore

4.1. Shoqëria është një person juridik shqiptar dhe është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.


Neni 5
Kohëzgjatja

5.1. Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 6
Qëllimi i Aktivitetit

6.1. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë konsiston në: Shoqëria do të kryejë aktivitete ekonomike në fushën e teknologjisë së informacionit, që konsistojnë dhe lidhen direkt me prodhimin, mirëmbajtjen, tregtimin dhe eksport-importin e pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardware dhe software.

Dizajni i software-it. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software.



Zhvillim dhe mirëmbajtje e sistemeve software. Këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që në funksionimin e tyre realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike.

Testim Software. Këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software.

Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re.

Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software. Digjitalizimi i arkivave të çdo lloji, arkivimi elektronik i të dhënave dhe mikrofilmimi, përpunimi elektronik i të dhënave, organizimi i bazave të të dhënave.

Gjithashtu shoqëria mund të kryej edhe aktivitete të tjera ekonomike që perputhen me legjistacionin shqiptar.

6.2 Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet i cili lidhet drejtpërdrejt, ose jo drejtpërdrejt me përmbushjen e aktivitetit kryesor të Shoqërisë edhe pse jo e përcaktuar specifikisht.

PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT

Neni 7 Kapitali i Shoqërisë

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 1000 Lekë.

7.2 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale prej 1000 Lekë.

7.3 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë u ofrua nga ortaku në shumën si më poshtë:

7.3.1 Orgito Baraj, qytetar me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 09/11/2003, shtetas shqiptar, mbajtës i Pasaportës/Letërnjoftimit me Nr. Personal K31109018T, ka kontribuar në Kapitalin e Shoqërisë me shumën prej 1000 Lekë.

7.4 Sipas kontributit të mësipërm, pronësia e Shoqërisë në kuota është si më poshtë:

7.4.1 Orgito Baraj, qytetar me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 09/11/2003, shtetas shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ Letërnjoftimit me Nr. Personal K31109018T, zotëron 1 kuotë, që korrespondon me 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.



PJESA III
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Neni 8

Përgjegjësia e Kufizuar

8.1 Ortakët janë përgjegjës deri në pjesën e vlerës së pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre, në Kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet e saj.

Neni 9

E Drejta e Votës

9.1 Secili prej Ortakëve ka të drejtën e votës në Asambleshë e Përgjithshme të Ortakëve. E drejta e votës ushtrohet dhe llogaritet në proporcion me vlerën përkatëse të kontributeve dhe përqindjes së zotëruar në Kapitalin e Shoqërisë.

9.2 Ortakëve i njihet e drejta për të marrë dividendë në rast shpërndarjeje të fitimit, si dhe e drejta e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë në proporcion me përqindjen e zotëruar në kapitalin e Shoqërisë ose ndryshe siç mund të përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 10

E Drejta e Pjesëmarrjes në Mbledhjen e Asamblesë

10.1 Ortakët do ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në vendimmarrjen e Shoqërisë nëpërmjet mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

10.2 Çdo Ortak ka të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë, qoftë personalisht ose nëpërmjet një autorizimi në përputhje me parashikimet e ligjit, të informohet mbi çështjet e Shoqërisë si dhe të inspektojë librat dhe regjistrat e Shoqërisë.

10.2.1 Ortakët mund të jenë të pranishëm në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, telekonferencës, mekanizmave që mundësojnë procesin e votimit pa qënë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje, video konferencës apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, me kusht që të sigurohet identifikimi i pjesëmarrjes së të pranishmëve dhe mjete elektronik i përdorur të garantojë transmetimin live, në kohë reale të komunikimit të ndërsjelltë, duke i dhënë mundësinë Ortakëve të adresojnë dhe diskutojnë nga vende të tjera në kohë reale dhe këto mjete të jenë objekt i masave teknike që sigurojnë sigurinë e komunikimit elektronik deri në masën e përdorimit proporcional në arritjen e qëllimeve. Me plotësimin dhe zbatimin e këtyre kriterëve, Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet Krytari dhe Sekretari i Mbledhjes, i ngarkuar me detyrën e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes dhe që ka të drejtën për të vendosur nënshkrimin përkatës.

Neni 11

Detyrimet e Ortakëve

11.1 Ortakët kanë detyrim:

- a. pagimin e kuotës përkatëse




- b. pjesëmarrjen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme ku ftohen rregullisht
- c. mbështetjen e Shoqërisë në kryerjen e veprimeve të saj
- d. përmbushjen e vendimeve të marra në mbledhjen e ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur, brenda qëllimit të autoritetit të tyre

PJESA IV
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Neni 12

Mbledhja e Përgjithshme e Ortakëve

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë i Shoqërisë, i cili ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
2. Asambleja e Përgjithshme do të mbahet nëse janë të pranishëm Ortakët që zotërojnë jo më pak se 50% në kapitalin e Shoqërisë ("**Kuorumi**"). Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të zhvillohen pa u plotësuar ky kuorum. Ortakët mund të jenë të pranishëm në mbledhje siç parashikohet në Klauzolën 10 ose nëpërmjet autorizimit.
3. Ortakët marrin pjesë dhe miratojnë vendime në Asamblesë e Ortakëve të Shoqërisë mbi këto çështje:
 - a. Modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti
 - b. Pranimin dhe përjashtimin e një ortaku, në përputhje me dispozitat përkatëse statutore dhe ligjore për t'u zbatuar
 - c. Dhënia e së drejtës së nënshkrimit dhe/ose opsionit për kuotat në Shoqëri
 - d. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët
 - e. Vendimi mbi bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë
 - f. Vendimi mbi blerjen apo diskutimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja
 - g. Vendimi mbi çfarëdolloj financimi të Shoqërisë
 - h. Kalimi i kompetencave Administratorëve (të përcaktuar më poshtë) ose Administratorit, të ndërmarrë financimin e Shoqërisë dhe/ose të ofrojë mjete financiare, të marrë përsipër detyrime, të ofrojë garanci ose letra garancie përtej EUR 5.000
 - i. Miratimi i raporteve vjetore dhe pasqyrat financiare si dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit
 - j. Lëshimi i mjeteve financiare, marrja përsipër e detyrimeve, lëshimi i garancive ose letra sigurie
 - k. Përcaktimi i parimeve e përgjithshme për politikën e biznesit të Shoqërisë
 - l. Hapja dhe mbyllja e degëve dhe përfaqësive



m. Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit/ve


n. Vendimi mbi çdo çështje tjetër, zgjidhja e së cilës i është rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga ligji ose nga ky Statut.

4. Një Ortak nuk do të transferojë kuotën përkatëse ose cdo pjesë të saj, të drejtat, interesat ose detyrimet e tij në ose si rrjedhojë e Shoqërisë, drejtpërdrejt ose jo, pa miratim paraprak me shkrim të Ortakut/ëve tjetër/të tjerë. Çdo përpjekje për të transferuar kuotën përkatëse ose pjesë të saj të Shoqërisë pa miratimin me shkrim të Ortakut(ëve) të tjerë do të jetë nul dhe i pavlefshëm ab initio.

5. Pavarësisht sa parashikuar në pikën 12.4 më lart, një Ortak që propozon të transferojë ose shesë kuotën përkatëse ose pjesë të saj nga sa zotëron në Shoqëri ("**Transferuesi**") tek një palë e tretë përfituese ("**Përfituesi i Propozuar**") i kërkohet t'ia transferojë këtë kuotë ("**Kuota që Shitet**") paraprakisht Ortakut/ëve të tjerë (në vijim referuar si "**Ortaku/ët i/e Mbetur**") në proporcion të njëjtë me pjesmarrjen e Ortakut/ëve të Mbetur në Kapitalin e Shoqërisë në atë moment, duke i dërguar një njoftim me shkrim (në vijim referuar si "**Njoftimi i Transfertës**"). Njoftimi i Transfertës do të specifikojë kuotën në tërësi ose pjesë të saj ("**Kuota për Shitje**") të propozuara për t'u transferuar, përqindjen e pjesmarrjes/zotërimit të Kuotës për Shitje që Ortaku/ët i/e Mbetur ka/në të drejtë të blejnë, identitetin e Përfituesit të Propozuar, çmimin për Kuotën për Shitje të ofruar nga Përfituesi i Propozuar dhe çdo material tjetër ose kushte dhe afate të tjera për shitjen e propozuar. Ortaku/ët i/e Mbetur do të kenë të drejtën, por jo detyrimin për të ushtruar të drejtën e Parablerjes ("**E Drejta e Parablerjes**"), t'i lëshojnë Transferuesit një shënim me shkrim ("**Njoftimin e Pranimit të së Drejtës së Parablerjes**"), për të pranuar ofertën për të blerë Kuotën për Shitje (ose çdo pjesë të saj që i përket Ortakut/ëve të Mbetur), në çmimin sikurse përmendet në Njoftimin e Transfertës. Transferimi i Kuotës për Shitje nga Transferuesi tek Ortaku/ët i/e Mbetur do të përfundohet brenda një periudhe prej 30 ditësh nga data e marrjes së Njoftimit të Pranimit të së Drejtës së Parablerjes, nëse Ortaku/ët e Mbetur kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të blerë Kuotën për Shitje në çmimin e përcaktuar në Njoftimin e Transferimit. Nëse Ortaku/ët i/e Mbetur refuzon ose nuk pranon ofertën e Transferuesit brenda afatit të caktuar në Njoftimin e së Drejtës së Parablerjes përmes dërgimit të një Njoftimi për Pranimin e së Drejtës së Parablerjes, Transferuesi do të ketë të drejtën të shesë ose transferojë Kuotën për Shitje (ose pjesë të saj për të cilin nuk është marrë një njoftim Pranimi i së Drejtës së Parablerjes) tek Transferuesi i Propozuar në çmimin dhe sipas kushteve të ofruara Ortakut/ëve i/të Mbetur në Njoftimin e Transfertës. Pavarësisht sa parashikuar këtu më lart, Ortaku/ët e Mbetur do të kenë të drejtën që të shkaktojnë që Shoqëria të blejë vetë Kuotën për Shitje në kushtet dhe afatet sikurse parashikohet në ligjet e aplikueshme dhe me çmimin sipas kushteve të ofruara Ortakut/ëve të Mbetur në Njoftimin e Transfertës. Transferuesi do të lehtësojë këtë blerje të Kuotës për Shitje nga Shoqëria duke siguruar miratimin/et e nevojshme gjatë mbledhjes së Ortakëve.

6. Në rast se në çdo kohë, kur mbas dy mbledhjesh të njëpasnjëshme të Asamblesë së Ortakëve,

(i) nuk bien dakort për realizimin e një plani veprimi (ose një plani veprimi të propozuar) në lidhje me çdo çështje të caktuar që kërkon votimin sikurse parashikohet në Nenin 12.3 më lart (një "**Çështje e Caktuar**"), ose



(ii) janë bllokuar lidhur me administrimin e aktivitetit të Shoqërisë, atëherë Ortaku/ët i/të cili/ët do t'ia referojnë këtë çështje për t'u zgjidhur nga një Ekspert i pavarur i caktuar prej tyre ("**Opinionit i Ekspertit**"). Opinioni i Ekspertit do të jetë i detyrueshëm për Ortakët, dhe Ortakët do ta zbatojnë këtë Opinion të Ekspertit brenda një periudhe prej 30 ditëve nga data e marrjes së tij. Në rast se Ortaku/ët dështon/jnë të përmbushë/in Opinionin e Ekspertit ("**Ortaku/ët Mospërmbushës**"), brenda kohës së parashikuar, Ortakët e tjerë ("**Ortakët Përmbushës**") kanë të drejtë të blejnë kuotat e Ortakut/ëve Mospërmbushës. Çmimi i kuotave të Ortakut/ëve Mospërmbushës do të përcaktohet në bazë të vlerësimit të kryer nga ekspert të kontabilitetit.

7. Në mbledhjen e Ortakëve, votimi do të mbahet i mbyllur.

8. Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga të gjithë Ortakët bashkarisht sipas këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

1. Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori, të paktën 2 herë në vit në selinë e Shoqërisë, ose në ndonjë vend tjetër.
2. Gjithashtu, administrimi ka detyrimin të thërrasë Asamblenë e Ortakëve nëse diçka e tillë kërkohet me shkrim nga të paktën një prej Ortakëve dhe nëse kërkohet nga administrimi në përputhje me dispozitat ligjore.
3. Asambleja e Ortakëve do të thirret me anë të shkruar, të dërguar nga Administratori. Njoftimi duhet të merret nga përfaqësuesi i Ortakëve nëpërmjet një letre rekomande, apo adrese elektronike (email), ose telexi apo faksi, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Ftesa e shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 14

Vendimet e marra në Asamblenë e Ortakëve

1. Nëse Asambleja e Ortakëve do të thirret në mënyrë të rregullt por nuk do të jetë i pranishëm ose i përfaqësuar numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur Kuorumin, atëherë Asambleja do të thirret përsëri brenda 30 ditëve dhe të gjithë Ortakët do të thirren përsëri në përputhje me parashikimet e Nenit 13. Axhenda e mbledhjes së dytë do të mbesë e pandryshuar.
2. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të merren edhe pa u mbledhur ortakët – p.sh. me anë të korrespondencës së shkruar, telekonferencës, video konferencës dhe të tjera mënyra të ngjashme – nëse të gjithë ortakët kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak për një gjë të tillë dhe identiteti i ortakëve mund të përcaktohet pa dyshim.

Neni 15

Drejtimi i mbledhjes së ortakëve

1. Secili nga Ortakët do të ketë të drejtën të caktojë një Kryetar të Asamblesë me rotacion, për një kohëzgjatje për jo më pak se 1 (një) vit.

2. Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e Ortakëve. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse Ortakët japin pëlqimin e tyre.

Neni 16

Procesverbali i mbledhjes së ortakëve

1. Për çdo mbledhje dhe për çdo vendim që do të merret në mbledhjen e ortakëve do të mbahet një procesverbal. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin Ortak.
2. Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe kundër-nënshkruhet nga Sekretari që e mban atë.
3. Kopjet e vendimeve përkatëse të Asamblesë së Ortakëve do t'u dërgohen të gjithë Ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas mbajtjes së Asamblesë së Ortakëve.
4. Kryetari është përgjegjës për mbajtjen dhe shpërndarjen e procesverbalit sipas parashikimeve të këtij statuti dhe ligjit.

PJESA V

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 17

Administrimi i Shoqërisë

1. Administratori/ët emërohet/n nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe të gjitha vendimet e marra nga ai/ata do të regjistrohen rregullisht.
2. Administratori/ët do të organizojë dhe menaxhojë aktivitetin e Shoqërisë. Ai/ata është/janë i/të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
3. Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
4. Duke marrë parasysh kufizimet e Nenit 12 sa më sipër, Administratori ka të drejta dhe i ushtron kompetencat sipas këtij Statuti dhe parashikimeve të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
5. Personi në vijim do të emërohet si Administrator:

Orgito Baraj madhor me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 09/11/2003, shtetas shqiptar mbajtës i Pasaportës/ Letërnjoftimit me Nr. Personal K31109018T emërohet si Administrator për një periudhë 5 vite, me të drejtë ripërtëritje.

PJESA VI

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 18

Viti Financiar, Pasqyrat Vjetore Financiare



1. Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

Neni 19

Fitimi i Shoqërisë

1. I gjithë, ose një pjesë e fitimit neto të Shoqërisë, mund t'i shpërndahet ortakëve në përputhje me pjesën e zotëruar prej tyre, sikurse mund të vendosë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Fitimi neto do të jetë fitim i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe alokimit të rezervave sipas Statutit ose ligjit.

Neni 20

Fondi Rezervë

1. Shoqëria do të krijojë një Fond Rezervë për grumbullimin e 20% të fitimit vjetor për zmadhimin e kapitalit dhe rastet emergjente, të njohur në vijim si ("**Fondi Rezervë.**")
2. Fondi Rezervë do të krijohet për qëllimet e mëposhtme:
 - a. Zgjerimin e Kapitalit: Fondi Rezervë do të përdoret për të mbështetur iniciativat e rritjes së shoqërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, projekte zgjerimi, hulumtim dhe zhvillim, përmirësime teknologjike dhe blerje pajisjesh;
 - b. Fondi i Emergjencave: Fondi i Emergjencave do të krijohet për përballimin e situatave emergjente, duke shërbyer si një mburojë financiare për të trajtuar ngjarje të parashikuara ose jo, si recesioni ekonomik, shpenzime të papritura ose pezullim të shoqërisë;
3. Shoqëria do të grumbullojë përqindjen e specifikuar të fitimeve neto në Fondin Rezervë brenda 30 ditëve pas mbylljes së çdo viti fiskal.
4. Fondi Rezervë do të ruhet në llogari të veçantë të përcaktuar vetëm për kapitalin dhe fondet emergjente, duke siguruar ndarjen e qartë nga fondet e tjera të shoqërisë.
5. Çdo interes i gjeneruar nga Fondi Rezervë do të ri-investohet në kapitalin dhe fondet emergjente, për të forcuar më tej qëllimin dhe ndikimin e tyre.
6. Ortakët pranojnë se grumbullimi i fitimeve për kapitalin dhe fondin rezervë është i rëndësishëm për mirëqenien financiare të kompanisë dhe pajtohen të respektojnë termat e përcaktuara në këtë Statut.

PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 21

Prishja dhe Likuidimi

1. Shoqëria do të prishet në rastet e mëposhtme:



- a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme
 - c. me hapjen e procedurave të falimentimit
 - d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2(dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë së shoqërisë
 - e. me vendim të gjykatës kompetente
 - f. për arsye të tjera të parashikuara në Statut
 - g. Në rast bashkimi me një Shoqëri tjetër
 - h. Në rast blerjeje nga një Shoqëri tjetër
2. Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e asetëve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe të legjislacionit në fuqi.

**PJESA VIII
TË PËRGJITHSHME**


**Neni 22
Të Ndryshme**

1. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çështjet të cilat nuk përfshihen në këtë Statut do të bëhet referim në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, dhe në veçanti, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Në rast mosmarrëveshesh të cilat mund të lindin si pasojë e zbatimit dhe interpretimit të këtij Statuti, ose për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe një pale të tretë do të zgjidhet miqësisht.

Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila, sot më datë 06/06/2023, në Tiranë

**O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Idealdevs Corporation" shpk**



Ortaku

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

